



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “BIBA- X” shpk

Adresa: Tiranë, Lekaj, Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50 m, prane Karburant “EURODRIN”.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikonstruksion i rrugës “Fatmir Haxhiu”.

Numri i referencës së procedurës/lotit REF-66730-05-03-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksion i rrugës “Fatmir Haxhiu”.

Fondi limit: 29,156,454 (njëzet e nëntë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 04.06.2018, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 18 datë 07.05.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk;

NUIS K66613407H

Vlera e ofertës = 20,962,743.90 (Njëzet milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e tre pike nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk

NUIS K47103804L

Vlera e ofertës = **21,560,630.07** (Njëzet e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë pike zero shtatë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Liqeni VII” sha

NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **22,152,123** (Njëzet e dy milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk

NUIS K51501008J

Vlera e ofertës = **22,555,555** (Njëzet e dy milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Alesio-2014” shpk

NUIS L41713003M

Vlera e ofertës = **23,266,850** (Njëzet e tre milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Labi” shpk & “Colombo” shpk
J67209289N & J82916489E**

Vlera e ofertës = **23,599,853** (Njëzet e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Bahas” shpk

NUIS J61827083D

Vlera e ofertës = **23,806,881** (Njëzet e tre milion e tetëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk.

NUIS J68310708M

Vlera e ofertës = **24,862,320** (Njëzet katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Biba-X” shpk.

NUIS K32618815N

Vlera e ofertës = **25,563,746** (Njëzet e pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk ;

- Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debit me Nr. 155 Prot. datë 03.05.2018 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në datën 31.03.2018 pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2018. Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit

kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit të publikuar më datë 04.05.2018 dhe zhvilluar më datë 04.06.2018.
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “e” të vendosur në DST, ç’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri Hidroteknik (E.B) i deklaruar nga Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë: 1 (një) punonjës teknik ndërtimi; 1 (një) punonjës hidraulik; 1 (një) punonjës pllakashtrues; 2 (dy) punonjës elektrikistë; 1 (një) punonjës saldatorë”, pasi ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 (një) punonjës elektrikist (H.H).
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, konstatoi se shoqëria “Euro-Alb” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk ;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Mjedisit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk është i pajisur me Çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- KVO, pasi verifikoi Shtojcën 10 konstatoi se mjeti Autobitumatriçe rezulton të jetë e montuar = Kamion me bot për spërkatje bitumi + bitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe”.

- Gjithashtu Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk për mjetin e sipërcituar nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucioni përkatës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Liqeni VII” sha ;

- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Autobitumatriçe”, të deklaruara në Shtojcën Nr.10, u konstatua se nuk është paraqitur çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “b” Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Kamionçine”, me targë AA 279 GG të deklaruar në Shtojcën Nr.10, u konstatua se çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, është paraqitur fotokopje e pa shoqëruar me vertetimin e noterizimit/njehsimit të fotokopjes me origjinalin çka bie në kundërshtim me Kriterin e paraqitur në Dokumentat standarte të Tenderit: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre”.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Kamionçine”, me targë DR 0532 E të deklaruar në Shtojcën Nr.10, u konstatua se mungon çertifikaten e kontrollit teknik e mjetit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “c”.
- Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit teknik, u konstaua se mungon CV e Inxhierit Topograf, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.

4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk ;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik për kamionçinën me targë AA 907 DD nuk ka paraqitur **çertifikatën e pronësisë së mjetit**, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “a”, ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi;

c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). **Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.**

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, konstatoi se shoqëria “Sireta 2F” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi Shtojcën 10 (Deklaratën mbi disponueshmërinë e mjeteve) të paraqitur nga shoqëria “Sireta 2F” shpk, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Alesio-2014” shpk ;

- KVO, pasi verifikoi Shtojcën 10 konstatoi se mjeti Autobitumatriçe me targë AA 704 PY rezulton të jetë e montuar = Kamion + bitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe”.
- Gjithashtu Operatori ekonomik “Alesio-2014” shpk për mjetin e sipërcituar nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucioni përkatës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Alesio-2014” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

6. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Labi” shpk & “Colombo” shpk

- Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Labi” shpk dhe “Colombo” shpk nuk ploteson Piken 6 te Kritereteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku percaktohet qe ofertuesit duhet te ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

7. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Bahas” shpk .

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Mjedisit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Bahas” shpk nuk është i pajisur me Çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Gjithashtu Operatori ekonomik “Bahas” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për Inxhinierin Elektrik, Inxhinierin Topograf si dhe për Inxhinierin e Mjedisit, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik për Autobotin e Ujit me targë AA 386 FK nuk ka paraqitur **çertifikatën e pronësisë së mjetit**, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “a”, ku përcaktohet se: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Bahas” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamionçina përkatësisht me targa TR 5154 L si dhe TR 3573 I. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për mjetet e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë TR 5154 L është deklaruar në procedurën me objekt: “Thellim dhe pastrim i kanalit të hapur tek ish liqeni i Shkozës” për të cilën Operatori ekonomik është shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Bahas” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “g”.

- Gjithashtu referuar Shtojcës 10, mjeti Autobitumatriçe dhe Autovinç me targë AA 485 TM janë deklaruar në procedurën me objekt: “Thellim dhe pastrim i kanalit të hapur tek ish liqeni i Shkozës” për të cilën Operatori ekonomik është shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Bahas” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “g”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Bahas” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

8. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Sterkaj” shpk.

- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 2 (dy) inxhinierë mjedisi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur për stafin teknik, konstatoi se njëri Inxhinier Mjedisi nuk është i pajisur me Çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ndërsa inxhinieri tjetër i mjedisit (D.K) i deklaruar nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit si dhe nuk ka librezë pune, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Shoqëria “Sterkaj” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe me targë TR 4893 L. KVO, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e sipërcituar, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucioni përkatës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “b”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatori ekonomik “BIBA - X” shpk, me adresë: Tiranë, Lekaj, Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50 m, prane Karburant “EURODRIN”, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **25,563,746** (Njëzet e pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.06.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, u paraqit ankesa nga operatori ekonomik “EURO-ALB” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me Nr.23908.Prot, datë 18.06.2018. Pas pezullimit të procedurës me Nr.17092/3. Prot, datë 18.06.2018 dhe ngritjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës me Nr.17092/4. Prot, datë 18.06.2018, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk pranoi ankesën e palës ankimuese duke i kthyer përgjigje me shkresën me Nr. 17092/6. Prot, datë 21.06.2018. Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga pala ankimuese pranë Komisionit të Prokurimit Publik në mbështetje të Nenit 63, pika 6 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), nuk u paraqit asnje ankesë.

